

KALLARATI



Ec ngado, Kallaratin mos e harro!

ORGAN PERIODIK I SHOQATËS K / A "KALLARATI"
Viti i 18-të i botimit, nr. 108, Prill - Gusht 2022, Çmimi 50 L
www.kallarati.com; E-mail: gazetakallarati@yahoo.it

NË KUJTIM TË 108 - VJETORIT TË QËNDRESËS SË KALLARATIT NDAJ ANDARTËVE GREKË

Faqe 3 - 4

LAVDI DËSHMORËVE TË KALLARATIT TË 1914-ës

Hyso Xhaferi, Murat Demiri, Çelo Boshi, Ramadan Hoxha, Dervish Maçi

Historia e Kallaratis, është e mbushur plot me akte trimërie e heroizmi, ashtu si gjithë historia e trevës së Labërisë dhe e "Kallarati, fshat i paktë" thotë poeti. Sepse pranuar dhe nuk e ka dhe pushtimin e huaj.ës, populli i Kallaratis andartët grekë, që cilët shkatërronin fshatin dhanë jetën 5 dëshmorë: Avdul Demiri, Çelo Maliq Ramadan Hoxha dhe u plagosën shumë bashkëfshatarë të tjerë



krejt Shqipërisë. **trima burrat, trime gratë**, populli i Kallaratis nuk e ka duruar asnjëherë sundimin Edhe në korrikun e 1914-nuk mund t'i duronte dot donin të pushtonin dhe tonë. Në këtë qëndresë Hyso Balil Xhaferi, Murat Boshi, Dervish Sali Maçi,

NDAHET NGA JETA KRYEREDAKTORI I GAZETËS "KALLARATI", VETERANI I LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE DHE USHTRAKU I LARTË, SEIT MAZE JONUZAJ

Faqe 2 - 3

(Mirënjohje për kontributin e dhënë ndaj vendlindjes)



Më 24 korrik 2022 u nda nga jeta në moshën 94 vjeçare, një nga pionierët e luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, një nga skënderbegasit e parë të shkollës ushtarake "Skënderbej", një nga kuadrot e lartë të marinës detare, ish kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të rrethit të Vlorës dhe kryeredaktori i gazetës tonë "Kallarati", Seit Maze Jonuzaj.

Seit Jonuzaj u lind në Kallarati të Vlorës më 29 janar 1928 në një familje me ndjenja të theksuara patriotike dhe atdhetare nga prindërit Maze e Xhevo Jonuzaj. I rritur në këtë ambient familjar të përkushtuar ndaj luftës kundër pushtuesve të vendit, përfshihet në lëvizjen nacionalçlirimtare, fillimisht si aktivist i rinisë antifashiste. Më 1944, në moshë fare të re, Seiti doli partizan në radhët e Brigadës 8-të Sulmuese, duke arritur me formacionet e kësaj brigade deri në afërsi të Vishegradit, ku e zuri urdhri i Komandës së Përgjithshme të UNÇL, që pionierët e formacioneve partizane të ktheheshin në Tiranë për të ndjekur shkollën ushtarake "Skënderbej".

TË NJOHIM DHE KUJTOJMË MËSUESIT TANË NË VITE



Nga Çize XHAFERAJ, ish nxënës dhe koleg

Marsi i vitit 1970 e goditi rëndë familjen e Bilal Breshanaj.

KUJTOJMË ME MIRËNJOHJE NJË NGA MËSUESIT E KALLARATIT, JAZO BAJRAM DAVACAJ

Nga Besnik Gjonbrataj



Më 25 prill të këtij viti po mbushen 23 vjet nga dita që Jazo Bajram Davacaj (Sinovarfi) është ndarë nga jeta në moshën 65 vjeçare. E kujtojnë atë sot si prind të shkëlqyer fëmijët e tij, **Bardha, Dafina, Havaja, Shpresa, Brunilda e Vojua**. E kujtojnë si gjysh të dashur nipërit dhe mbesat. E kujtojnë ish nxënësit dhe kolegët e tij mësues, në Dushkarak, Bolenë, Mesaplik, Kuç e Kallarati, si një mësimdhënës tepër të aftë. E kujtojnë bujqit e blegtorët kallaratas, me të cilët punoi për gati 15 vjet. Por Jazon e kujtojnë edhe të gjithë bashkëfshatarët e tij, si një njeri të mirë, të ditur, të dashur, punëtor e me karakter të fortë, tolerant dhe jo hakmarrës. Por mbi të gjitha Jazon e kujtojnë ish nxënësit në gjithë zonën ku punoi në arsim, si një ndër mësuesit më të përgatitur dhe të aftë të lëndës së matematikës.

Faqe 7

AGIM MATAJ (KALLARATI), REALIZON MEMORIALIN E GREQISË SALENTINE NË LEÇE TË ITALISË

Faqe 6



Po çfarë paraqet në vetvete monumenti?

Siç tregon Agimi, ai është krejtësisht punim artistik prej guri (pietra leccese) e ndërtuar sipas idesë së tij, me simbole të veçanta në greqisht për të treguar se në këtë zonë jeton një komunitet me origjinë të hershme greke. Në të katër faqet e kolonës janë gdhendur stemat e secilit fshat, ndërsa në bazament në dy anë të kundërta është gdhendur, në një anë simboli i Greqisë dhe në tjetrën stema

e Greqisë Salentine, ndërsa në dy faqet e tjera është shkruar në njërin italisht e në tjetrën greqisht eventin për të cilin u bë ceremonia.

Më 21 gusht 2022 në Kallarati u zhvillua "Takimi i Brezave"

Në organizimin e këtij takimi të brezave, meritë kanë ata që sponsorizuan, si Mirjan Rib, Aranit Rjepi, bizneset me një shërbim të përsosur, si përherë Zeqo Hoxha familjarisht, por kësaj radhe edhe Vangjel Rib me ekipin e tij, të cilët ia shtuan bukurinë takimit të brezave. Jemi të ndërgjegjshëm se, nëse njoftimi do të kishte

qenë shumë më herët, pjesëmarrja do të ishte shumë më e madhe, sidomos nga emigrantët, problem që vitin tjetër duhet të mbahet në konsideratë që masat për organizimin dhe njoftimin e datës së takimit të brezave, duhet bërë jo më vonë se muaji mars të çdo viti. Ajo që ranë sy kësaj radhe ishte pjesëmarrja e fisit Zeqaj të Kallaratis me banim në Borsh, të cilët për herë të parë iu bashkuan bashkëfshatarëve të tyre, ashtu si edhe pjesëtarët e fisit Jonuzaj të Penkovës dhe plot të tjerë. Nga fshatrat fqinjë do të veçonim grupin e Vranishtit të ulur në një tavolinë të veçantë, të cilët me këngët labe të kënduara e gjallëruan së tepërmi veprimtarinë festive.

Faqe 5 - 6



"Takimi i Brezave" në Kallarati
21 Gusht 2022
Ora 19:00
Ju mirëpresim!

5 MAJI, “Dita e Dëshmorëve të Atdheut”



Në këtë ditë të shënuar, le të kujtojmë me respekt të thellë jetën dhe veprën e dëshmorëve të Kallaratit dhe të krejt Shqipërisë, që dhanë jetën për çlirim e vendit nga pushtuesit e huaj dhe për mbrojtjen e demokracisë!

NË KALLARAT PËRKUJTOHEN DHE NDEROHEN DËSHMORËT.

Edhe banorët e Kallaratit më 5 maj 2022, kujtuan dëshmorët e fshatit që dhanë jetën për çlirim e vendit. Me këtë rast pranë lapidarit në emër të Bashkisë Himarë, Këshillit të fshatit, Organizatës së Dëshmorëve dhe Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, familjeve të dëshmorëve u vendosën kurora e buqeta me lule. Vlerësim e mirënjohje gjithë atyre që dhanë jetën dhe kontributin për lirinë e atdheut! Mirënjohje dhe gjithë bashkëfshatarëve në Kallarat që morën pjesë në këtë përkujtim.

Lavdi për jetë dëshmorëve të Kallaratit!

Rënë në luftë ndaj andartëve grekë më 1914.

1. Murat Avdul Demiraj
2. Dervish Sali Maçaj
3. Ramadan Muhamet Hoxhaj
4. Çelo Mustafa Boshaj
5. Hyso Balil Xhaferaj

Rënë në luftë kundër fashistëve Italianë më 1920.

1. Xhevair Musa Gollosaj
1. Mumin Selam Bajramaj
2. Adil Lame Petanaj
3. Ali Birçe Ribaj
4. Ali Sulo Memushaj
5. Avdul Demir Demiraj
6. Ferik Miftar Gollosaj
7. Ferik Teslim Strataj
8. Filo Faslli Breshanaj
9. Hamdi Shuaip Sheraj
10. Hamza Malo Qejvanaj
11. Hasan Laze Qejvanaj
12. Islam Tasim Janjaj
13. Lilo Dine Habilaj
14. Nelo Nazer Hysaj
15. Nexhip Shuaip Sheraj
16. Nuredin Selam Breshanaj
17. Ormen Boro Ribaj
18. Shuko Ramo Karabollaj
19. Tare Çelo Gjonaj
20. Zyber Shuaip Sheraj



Rënë për mbrojtjen e demokracisë

1. Elham Sulejman Sheraj (Elezi)

Qoftë i paharruar kujtimi i tyre!



NDAHET NGA JETA KRYEREDAKTORI I GAZETËS “KALLARATI”, VETERANI I LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE DHE USHTRAKU I LARTË, SEIT MAZE JONUZAJ.

(Mirënjohje për kontributin e dhënë ndaj vendlindjes)



Më 24 korrik 2022 u nda nga jeta në moshën 94 vjeçare, një nga pionierët e luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, një nga skënderbegasit e parë të shkollës ushtarake "Skënderbej", një nga kuadrot e lartë të marinës detare, ish kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të rrethit të Vlorës dhe kryeredaktori i gazetës tonë "Kallarati", Seit Maze Jonuzaj.

Seit Jonuzaj u lind në Kallarat të Vlorës më 29 janar 1928 në një familja me ndjenja të theksuara patriotike dhe atdhetare nga prindërit Maze e Xhevo Jonuzaj. I rritur në këtë ambient familjar të përkushtuar ndaj luftës kundër pushtuesve të vendit, përfshihet në lëvizjen nacionalçlirimtare, fillimisht si aktivist i rinisë antifashiste. Më 1944, në moshë fare të re, Seiti doli partizan në radhët e Brigadës 8-të Sulmuese, duke arritur me formacionet e kësaj brigade deri në afërsi të Vishegradit, ku e zuri urdhri i Komandës së Përgjithshme të UNÇL, që pionierët e formacioneve partizane të ktheheshin në Tiranë për të ndjekur shkollën ushtarake "Skënderbej".



Pas mbarimit të shkollës ushtarake "Skënderbej", në tetor 1947 u dërgua për studime në Akademinë Detare të Splitit, ku qëndroi vetëm një vit për shkak të prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë. Prej vitit 1948–52 studioi në Akademinë Detare "Kirov" në Baku të BRSS, kurse gjatë 1955-57 kreu kualifikimin pasuniversitar në fakultetin e lundrimit në Leningrad (Shën Petërsburg).

Ka kryer detyra të ndryshme komanduese në përbërje të Flotës Luftarake-Detare, në fillim si Komandant Anijeje, pastaj si Shef i Degës së Lundrimit në Komandën e Forcave Detare, si Shef i Shtabit të Brigadës së Anijeve Mbiujëse në Sazan dhe Shef i Shërbimit Hidrografik të Forcave Detare. Prej vitit 1972 e deri më 1985 ka qenë pedagog në Akademinë Ushtarake "Mehmet Shehu" (1972–75) dhe në Akademinë e Detarisë në Vlorë (1975–85), ku, pas daljes në pension, ka vijuar si pedagog i jashtëm në Universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës, si dhe detyra të tjera.

Ka lundruar në detet e Mesdheut dhe jashtë tij me anije ushtarake e tregtare (1952-1983). Ka udhëhequr ekspedita studimore hidrografike e hidrologjike në Adriatik e Jon (1964). Ka marrë pjesë si kryespecialist lundrimi në realizimin e çminimit të ngushticës së Korfuzit (1958). Seiti ishte njohës i 4 gjuhëve të huaja.



Ai ka mbajtur një varg kumtesash mbi leksikon detar dhe mbi traditat detare të popullit shqiptar. Ka botuar, si autor e bashkautor, një varg librash në fushën e detarisë, si "Udhëzues lundrimi për detin Adriatik e Jon", "Fjalor i termave të detarisë", "Parandalimi i përplasjeve në det", "Historia e Detarisë shqiptare në rrjedhën e kohës", si dhe disa rregullore lundrimi etj. Është autor i shumë kumtimeve në tubime shkencore dhe i mjaft artikujve shkencorë të botuar në shtypin shkencor, si dhe i një fjalori

4-gjuhësh me mbi 8000 terma të detarisë.

Me daljen në pension Seiti nuk e ndërpreu aspak aktivitetin e tij shkencor e shoqëror. Ai iu përkushtua veprimtarisë shoqërore në lagje dhe në qytetin e Vlorës. Prej disa vitesh kreu detyrën e Kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të rrethit të Vlorës, vitin e fundit për shkak të moshës "Kryetar Nderi" i kësaj organizate.



Seiti e deshi shumë vendlindjen Kallaratit, Vlorën e Labërinë dhe iu përkushtua historisë, vlerësimit të luftës nacionalçlirimtare dhe figurave të tij. Për shumë vite ai ishte kryeredaktor i gazetës "Kallarati", si dhe ka dhënë një kontribut mjaft të rëndësishëm në krijimin dhe funksionimin e shoqatës "Kallarati. Ka botuar libra dhe artikujt të shumtë kushtuar vendlindjes, datave historike dhe figurave të shquara të Kallaratit.

Ai ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në median e shkruar si në shtypin ushtarak, gazetën "Labëria", gazetën "Kushtrim Brezash" dhe shtypin në përgjithësi e në mediat lokale të Vlorës. Me punën e tij plot pasione përkushtim punonte që brezave të rinj t'iu transmetonte ndjenjën patriotike dhe atdhetare e dashurinë ndaj atdheut. Ndjenja kombëtare për të ishte mbi gjithçka. Ai ishte i prerë dhe kundërshtar i rreptë i atyre që donin të shtrembëronin historinë dhe të përbuznin luftën heroike të popullit shqiptar ndaj pushtuesve fashistë e nazistë.

NË KUJTIM TË 108 - VJETORIT TË QËNDRESËS SË KALLARATIT NDAJ ANDARTËVE GREKË

LAVDI DËSHMORËVE TË KALLARATIT TË 1914-ës

Hyso Xhaferi, Murat Demiri, Çelo Boshi, Ramadan Hoxha, Dervish Maçi



Historia e Kallaratis, është e mbushur plot me akte trimërie e heroizmi, ashtu si gjithë historia e trevës së Labërisë dhe e krejt Shqipërisë.

"Kallarati, fshat i paktë trima burrat, trime gratë", thotë poeti. Sepse populli i Kallaratis nuk e ka pranuar dhe nuk e ka duruar asnjëherë sundimin dhe pushtimin e huaj. Edhe në korrikun e 1914-ës, populli i Kallaratis nuk mund t'i duronte dot andartët grekë, që cilët donin të pushtonin dhe shkatërronin fshatin tonë. Në këtë qëndresë dhanë jetën 5 dëshmorë: Hyso Balil Xhaferi, Murat Avdul Demiri, Çelo Maliq Boshi, Dervish Sali Maçi, Ramadan Hoxha dhe u plagosën shumë bashkëfshatarë të tjerë

Kanë kaluar jo pak vite, por 108 të tillë dhe jeta, kontributi i tyre kujtohet me mjaft krenari, ashtu siç kujtohet jeta dhe vepra e gjithë dëshmorëve kallaratas të luftës së 1920-ës, luftës antifashiste e deri te dëshmori i fundit i periudhës së demokracisë, të cilët e kanë radhitur Kallaratin përkrah fshatrave të tjerë të Vlorës, Labërisë dhe krejt Shqipërisë si kontribues i lirisë dhe pavarësisë popullit tonë.

"FSHATI I DJEGUR", POEZI



Nga Hiqmet Meçaj

Kallarati, fshatit të nënës dhe të babait, të cilin të gjithë pushtuesit e kanë djegur dhe bashkëfshatarët e mi e kanë ngritur prapë.

Ka vetëm mure,
ka vetëm hi,
dyer nuk ka.
Ku të trokas?
Ku të trokas?
Kujt t'i thërras?
Kujt t'i thërras?
Nën hi dhimbje e madhe,
dhimbje e madhe mbi hi.
Djegur ditët,
djegur netët,
djegur mëngjeset
dhe mbrëmjet djegur.
O, mos trokit,
o, mos kërk,
nën hi e mbi hi,
ditë e net djegur.
Po rri me djalin,
i mësoj të lexojë germadhat,
të kuptojë sa i shtrenjtë është bari
nën muret e djegura nga barbarët.
Rilindin mëngjeset,
rilindin mbrëmjet,
rilindin ditët,
rilindin netët.
Im bir kokën në frëngji e mbështet,
mbulohet nga bari i gjelbër.

NJË FSHAT I VOGËL NË BRINJË...

Pamja që të afron sot "Fshati i Djegur" më shtyu që të shkruaj rreth asaj ngjarje që la gjurmë në historinë e Kallaratis. La gjurmë sepse u krijua një toponim i ri nga një ngjarje me motive patriotike, atdhedashëse. La gjurmë sepse mund të jetë nga të paktat objekte shekullore në Shqipëri që edhe sot ruhen si dëshmi të oreksit shovinist antishqiptar të fqinjëve jugor grekë. Koha ka bërë të vetën për 108 vjet, gurët kanë lëvizur, muret kanë zënë myshk por trojet shtëpi, xhamia, Harca e fshatit, Shala e Çipit, Qafa e Pirrës e Gjothanasi janë aty si dëshmitarë të pavdekshëm për të na treguar historinë e asaj qëndrese në vapën përvëluese të korrikut e në zjarrin e madh të fillimit të Luftës së Parë Botërore. Sot kur mbushen 108 vjet nga 14



Nga Lefter Hysaj

Korriku i vitit 1914, ngjarje të tilla si lufta e kallaratasve kundër andartëve grekë duhet të na ngjallin refleksione.

Historia bëhet por shkruhet për t'u mësuar.

Kallaratasit gjithmonë kanë shkruar pas rrjedhës patriotike. Gjithmonë në ngjarje të mëdha gjen burra kallaratas që e "shënuan" emrin e fshatit të tyre në librin e nderit.

...Kallarati 100 shtëpi

Në mes të kazasë rroftë...

Pjesëmarrje në kryengritjet e vitit 1847, në lëvizjen patriotike të Rilindjes Shqiptare, në ngjarjet e para pavarësisë, në pjesëmarrjen në Kuvendin e Vlorës, në Luftën e 1920-ës e më vonë tregojnë se kallaratasit ishin atdhedashës e me gjakun e tyre mbrojtën trojet e vatanet pjesë e atdheut.

...Atdheu fillon tek vetja...

Shpallja e Pavarësisë në 28 Nëntor 1912 ishte ngjarje kulmore që gëzoi zemrat e shqiptarëve në të gjitha trojet. Dëshmitarë të haresë së madhe që zotëroi Vlorën ato ditë u bënë edhe kallaratasit Meçan Selami, Lame Petani dhe Hodo Kalemi të cilët morën pjesë në mitingun e Shpalljes së Pavarësisë. Krijimi i Qeverisë së Vlorës ngjalli shpresat se "Shqipëria do të bëhej...", por synimet shoviniste të fqinjëve të mbështetur edhe nga një pjesë e Fuqive të Mëdha të kohës bënë që ...Shqipëria u bë, por u bë e vogël, e gjymtuar duke shkëputur nga trupi i saj gjysmën e territoreve dhe popullsisë.

Megjithëse Kosova, Ulqini, Plava e Gucia, Tetova e Struga, Kumanova e Dibra, Paramithia e Filati, Preveze e Margëlliçi mbetën jashtë Shqipërisë oreksi i serbeve, malazezëve e grekëve nuk u kënaq. Rënia e Perandorisë Otomane i dha shkas fqinjëve që me luftërat ballkanike dhe marrëveshjet midis tyre ta sakatonin më tej Shqipërinë... një shtet midis Matit e Vjosës... kjo duhet të ishte Shqipëria.

... "Shqipëria fillon përtej maleve veriore të Epirit dhe kufiri veri-perëndimor i Greqisë duhet të jetë lumi i Vjosës..." ky ishte plani Grek. Nga Karaburunin në Qafën e Llogarasë, në Qafën e Gurrës, në Kallarati, Bolenë, Tepelenë, Këlcyrë e Korçë, kjo ishte vija që linte brenda Vorioepirit e Greqisë edhe Kallaratin.

Lufta e 1914-ës në Kallarati nuk u shkaktua... ngaqë ca djem vranë një pararojë greke... lufta e kallaratasve ashtu si e tërë kurveleshasve ishte luftë për mbrojtjen e atdheut nga aneksimi grek, ishte pjesë e asaj lëvizje të madhe kombëtare që nisi me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, e cila duhet nderuar se ndoshta për herë të vetme u hartua një program me katër pika, ku prioritet ishte bashkimi i trojeve shqiptare.

Them "ndoshta" sepse qeveritë shqiptare që u krijuan e qeverisën më vonë Shqipërinë, disa nga rrethanat e pavolitshme historike, të tjera nga përlulesia e servilizmi ndaj fuqive

NDAHET NGA JETA KRYEREDAKTORI I GAZETËS "KALLARATI", VETERANI I LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE DHE USHTRAKU I LARTË, SEIT MAZE JONUZAJ.

(Mirënjohje për kontributin e dhënë ndaj vendlindjes)



Për kontributin e tij ndaj vendlindjes, Labërisë dhe qytetit të Vlorës, Seiti i është dhënë "Certifikata e Mirënjohjes" nga Shoqata Kallarati; "Mirënjohja e Labërisë" nga shoqata Labëria; "Mirënjohje e qytetit të Vlorës" nga Bashkia e qytetit të Vlorës. "Certifikata e Mirënjohjes" nga Shefi Shtabit të Përgjithshëm të FA; "Certifikata e Mirënjohjes" nga Ministri i Mbrojtjes, "Nderi i Organizatës së veteranëve të LANÇ-it" nga Kryesia e Komitetit Kombëtar të Veteranëve të LANÇ-it, rreth 12 dekorata të luftës e të punës, nga Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe autoritete të tjera të vendit, si dhe medaljen për pjesëmarrjen në luftën ndaj fashizmit, nga federata ruse, etj, vlerësime, të cilat ia hijeshonin gjoksin e tij. Seiti përveç se një ushtarak i zoti, një veprimtar i shquar shoqëror, ishte edhe një bashkëshort i mirë, një prind i shkëlqyer, një gjysh i dashur e një familjar i rregullt.

Seiti për shumë vite e kishte sfiduar moshën dhe ishte tepër aktiv në jetën shoqërore edhe pse në një moshë të thyer 94 - vjeçare, por ditët e fundit moshë nuk mundi ta përballonte sëmundjen, duke mbyllur për gjithmonë sytë. Ai u nda nga jeta fizikisht, duke lënë pas një emër të nderuar dhe një pasuri të madhe artikuluesh, librash e studimesh të rëndësishme për ushtrinë, për luftën dhe vendlindjen.

Pikërisht për gjithë këto merita e angazhime të tija, bëri që bashkia e Vlorës dhe shoqata "Kallarati" ta përcillte me nderime, ashtu siç i ka hije një veterani, duke kryer homazhet e fundit nga kinoteatri "Petro Marko" të qytetit të Vlorës.

Kryesia e Shoqatës "Kallarati" i shpreh familjes dhe të afërmve ngushëllimet më të thella e të sinqerta! Njerëz me kontribute si Seit Jonuzaj mbeten të pavdekshëm në memorien tonë. Lavdi jetës së Tij!

NË KUJTIM TË 108 - VJETORIT TË QËNDRESËS SË KALLARATIT NDAJ ANDARTËVE GREKË

LAVDI DËSHMORËVE TË KALLARATIT TË 1914-ës

Hyso Xhaferi, Murat Demiri, Çelo Boshi, Ramadan Hoxha, Dervish Maçi

të mëdha e qeverive fqinje, të tjera nga miopia dhe interesa te ngushta të vetat apo të momentit asnjëherë nuk arritën të bashkojnë mendjet shqiptare për të hartuar një program të qartë të bashkimit kombëtar.

Grekët dhe serbët pavarësisht sloganeve të integritimit i kanë që nga 1840 programet e tyre të "Megaliidhe-së" e "Naçertanies" e i ruajnë edhe sot në sirtar, i nxjerrin herë pas herë hapur apo fshehtas dhe veprojnë kundër interesave shqiptare. Shembujt janë jo të paktë nga 1912 e deri më sot.

Le të kthehemi te Korriku i 1914-ës. Në Nëntor 1912 repartet e ushtrisë greke nën komandën e Spiro Milos zbarkuan në Himarë. Qëllimi i tyre ishte që të siguronin krahun veri-perëndimor te Vorioepirit e me anë të pushtimit të moslejonin shtrirjen e pushtetit të qeverisë së Vlorës përtej Qafës së Llogarasë. Në një telegram të komandantit të garnizonit të Kuçit në Kurvelesh që mban datën 8 dhjetor 1912, drejtuar Kryetarit të Qeverisë së Përkohëshme, zotit Ismail Qemali thuhet: "Sot në Liman të Palermos nën roje të dy kryqëzorëve, kanë dalë dy vaporë transporti me ushtarë grek". Në kushtet kur Qeveria e Vlorës ishte në fillimet e veprimtarisë së saj e në rrethana të pafavorshme sepse hapësira gjeografike ku vepronte ishte e kufizuar dhe mundësitë materiale i kishte të pakta, Ismail Qemali më 9 Dhjetor 1912 i kthen përgjigje komandës së garnizonit Kuç. "...presim nga zelli juaj patriotik... për të ruajtur katundet tuaja".

Kështu që krahinave të jugut të Shqipërisë u mbetj të përballeshin me forcat greke që në drejtime e forma të ndryshme përpiqeshin të realizonin synimin e tyre. Në krahina dhe fshatra u krijuan komisione për të drejtuar luftimet kundër forcave greke. Ne 26 Dhjetor 1912 Kryetari i Komisionit të Mbrojtjes Kombëtare të Delvinës Mehmet Ali Pasha, i drejton telegram Kryetarit të Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës ku i shkruan: "Për t'i bërë ballë sulmit të grekëve në Himarë duhet të përqëndrohen nëpër postet e asaj ane rezervistët e vullnetarët e fshatrave të lidhura me kazanë e Vlorës, si ato te Kuçit, Bolenës e Kallaratis." Lufta kundër forcave greke në vitet 1912-1914 ishte lufta e popullit të vetorganizuar për të mbrojtur çdo pëllëmbë tokë. Kallaratasit u bënë pjesëmarrës aktiv në këtë luftë. Ata i bënë kërkesë Qeverisë së Vlorës për ndihmë në armatime dhe Selam Barjami, Beqir Xhibaj e Ramo Karabollli sollën në fshat 60 armë. Ndërkohë që kurveleshasit përpiqeshin të organizoheshin, forcat greke filluan sumin për të hyrë në brendësi të krahinës ku u ndeshën me armët e barinjve. Kjo ndodhi edhe në Gjothanas ku kallaratasit Muco Karabollli, Yzeir Ribaj, Sali Maçi i pritën me armë pushtuesit dhe dhanë jetën nga torturat në burgun e Korfuzit.

**... Gjothanas sipër në gropa,
lufton sa dridhet Evropa...**

Kjo situatë ku kurveleshasit e gjithë jugu përpiquej t'i bente ballë ushtrisë greke vijoi gjatë vitit 1913 dhe gjysmën e parë të 1914, ndërkohë që në skenën politike ndodhën ndryshime. Qeveria e Vlorës dhe Ismail Qemali në kushte teje të pafavorshme të brendshme (veprimet anti shqiptare të Esat Toptanit) dhe të jashtme, ardhja e KNK dhe veprimet e fqinjëve me përkrahjen e disa Fuqive të Mëdha dha dorëheqjen, kështu që lufta ndaj pushtuesve grekë udhëhiqej vetëm nga vetëdija popullore.

Ne 14 Korrik 1914 forcat greke me një udhërrëfyes shqiptar, sulmuan Kallaratin nga disa drejtime. Fshati krijoi Komisionin e Mbrojtjes të përbërë nga Selam Barjami, Alem Toto, Hodo Shakaj, Lame Petani e Hyso Balili. Komisioni bëri thirrje për organizimin e mbrojtjes ku 121 burra e 38 gra u bënë pjesë e "murit të gjallë" që bëri historinë.

**...çpaskej një telim të mirë,
40 burra një të shtirë...**

Forcat prej qindra grekësh më së fundi pas një qëndrese të gjatë ku dhanë jetën Murat Avduli, Çelo Boshi, Hyso Balili, Dervish Maçi e Ramadan Hoxha e u plagosën gjashtë persona të tjerë e pushtuan dhe e dogjën fshatin.

Që atëherë kallaratasit u shpërngulën dhe fshatit të bukur në Pllajën e Pilingrisë i mbeti emri "Fshati i Djegur", për të na kujtuar se Atdheu ynë është ky truall i zhuritur nga luftrat janë këto troje dëshmi e historisë, janë varret e të rënëve në luftë për liri, janë këngët prush e zjarr të popullit, është gjuha e bukur shqipe "nishani" që na dallon nga kombet e tjera dhe kolona vertebrore që i lidh shqiptarët nga Mitrovica në Prevezë, nga Durrësi e Ulqini në Preshevë, Shkup e Manastir.

"KALLARAT - NJËQIND SHTËPI", VJERSHË E NASE BENIT PËR KALLARATIN



Kur lexon vjershat e Nase Benit nga Vunoj, një ndjenjë krenarie të pushton për këtë poet popullor të spikatur. Forca e përshkrimit në vargje, figuracioni i hollë, muzikaliteti në kolonën e gjatë të vjershave e të tjera tipare të vjershërimit të tij të gëzojnë e frymëzojnë.



Nga Idajet JAHAI

Gjithsesi e ndjen veten si në përjetimin e një kënge liriko-heroike, ku spikat krenaria atdhetare. Ai shkruan për sakrificat të popullit, por mbi to kumbon madhështia e qëndresës; ravijëzon drama historike, po nga ato shkëlqejnë mesazhe e ideale të mëdha. E, në funksion të këtyre vlerave, ritmi e rima (dyshe), përsëritëse deri në fund të vjershës (mono-dyshe-rimë) gjëmon vala e isos, në një kadencë të ëmbël popullore, me figuracione e detaje të imta, që pikturojnë më mirë tablonë.

Prej këtij poeti vunjotës na kanë mbetur deri më sot shtatë vjersha. Ai, sigurisht, ka shkruar shumë të tilla, por edhe në këto që disponojmë, që i kanë mbijetuar shekullit, shohim poetikën e tyre të lartë. Vjershat janë të llojit-himn, si "Evropa shkruajnë e thonë" (nga më të njohurat, në mos himni kryesor i epopesë së 20-s); "Himara në breg të detit"-një perlë lirike e rivierës; "Vaj medet, Çika me borë" (një epizëm meditativ për historinë); "O Himarë e Toskërisë"- një qortim për disa të gënjyer që përkrahnin megaliidhenë) etj.

Nasia ka qenë poeti i temave të mëdha, i tonacioneve madhore e të ëmbla epike. Në to kumbon lirika atdhetare, virtytet e shqiptarëve, natyra kartolinë, krenaria etnike. Ai ka qenë një këngëtar i shquar, një tribun kënge, daveti, mbledhës. Thonë se vjershën "Kush është lulja e vilajetit" (për Himarën) e ka kënduar një natë të verës së vitit 1920 në Kaninë, për t'u krenuar me rivierën e tij e historinë e saj.



Por këtu veçojmë njëren prej vjershave të tij historike, atë për Kallaratin. Atë e thuri pas luftës që u zhvillua aty me andartët grekë më 1914, ku mori pjesë edhe vetë Nasja me vëllain e tij Pilon. Vjersha titullohet "Kallarati-njëqind shtëpi". Në korrikun e atij viti kallaratasit bënë luftë të ashpër me grekët gjiritlinj, siç i quan poeti. Ata e dogjën fshatin, por edhe vetë lanë kërrmat e tyre aty. Ata ishin një forcë e madhe, e ardhur nga Kreta, të dërguar prej qeverisë greke e të bekuar

prej Fanarit grek. Komandanti i tyre, Cullaqi, shoqërohej nga dy tradhtarët tanë... Por ata gjetën vdekjen aty nga plumbat e trimave kallaratas e të Nase Benit me shokë.

Vjersha jep shumë informacion për atë luftë: "Fshati 100 shtëpi"; përmenden emrat e disa prej luftëtarëve kallaratas, nga të cilët disa prej tyre ranë në luftime: Ramadan Gjiziu, Murat Avduli, Hyso Balili, Çelo Boshi, Dervish Saliu (Maçi)... Vijëzohen virtyte të luftëtarëve, trimëria, veshja e ndonjërit, copëtimi nga bombat, mostërheqja nga lufta; mundja e armikut etj. Vetë kapitenit të tyre "i mbeti kapelja në gropë"... Muzikaliteti i vjershës e shton edhe më shumë frymën heroike të luftëtarëve të popullit.

Ja teksti i këngës:

Kallarati 100 shtëpi,
Luftuan me trimëri,
Për vatan qenë të zotë;
Gjithë vendi në pusi,
I gjithë fshati u dogj,
Bëhet luftë me syngji,
Po derdhet gjaku me okë;
U vranë ca djem të rij,
U vranë ca djem të zotë;
Ramadani i Gjizi,
U godit mu në çapokë;
Murati xhamadani,
Pse s'del në lëmë e në portë;
Humbi atë pasuri,
Salltaneti treqind kokë!
Njëqind dhën e dyqind dhi,
Dhe mushkë e kuqe me lopë;
Gjithë trima-djem të rij,
Hyso Balili me shokë;
Çelo Boshi, djalë i ri,

E bë bomba copë-copë.
I shkreti Dervish Sali,
E mori plumbi në kokë,
Do mbetet në histori,
Do lëvdonetë në shokë;
Kapetani gjiritli,
E mori plumbi në kokë,
Mu si derr në tokë u shtri,
I mbet kapelja në gropë!...*)

Populli i Kallaratis ua ka kthyer nderimin dhe fisnikërinë trimave të Bregut, Nase e Pilo Andoni, me vargjet:

...Foli Nase Beni vetë
Me Pilon që të dy,
Patriotë të vërtetë,
Me pushkë e libra në gji...

*) Marrë nga F. M. Rrapi, "Këngë popullore të Labërisë", Tiranë 1991, f. 1104.

Më 21 gusht 2022 në Kallarat u zhvillua "Takimi i Brezave"

(Përmbledhje për gazetën, nga Besnik Gjonbrataj)



Takimi i brezave, tashmë është kthyer në një traditë, për të gjitha fshatrat e Labërisë, patjetër edhe për fshatin tonë. Megjithatë njoftimi këtë vit, për shumë arsye objektive, u bë me vonësë, kallarasit dhe jo vetëm ishin të pranishëm në mbrëmjen e datës 21 gusht në sheshin para lapidarit dhe restorantit të Zeqo Hoxhës. Të ardhur nga Vlora, Fieri, Durrësi, Tirana, e qytete të tjera, bile edhe nga emigrantët tanë në Greqi,

Itali, Amerikë etj, por edhe nga fshatrat përreth Kallaratit, si Vranishti, Bolena e Kuçi, në një ambient tepër festiv, veshur me banderola e parulla, si dhe të një ndriçimi të plotë, nën tingujt e muzikës popullore dhe të zërit brilant të këngëtarit, birit të Kallaratit, Gjergj Leskaj, bëri që sheshi të gumëzhinte gjatë gjithë natës të datës 21 gusht. Bashkëfshatarët të organizuar në bazë familje, por edhe fisi, me tavolina e karrige të vendosura bukur, improvizuar secili një trapez si dikur u kërcyen vallet popullore, u këndua labçe dhe u ngrit dollia nën shoqërimin e mishit të pjekur në hell, karakteristikë e zonës së Labërisë.



Në organizimin e këtij takimi të brezave, meritë kanë ata që sponsorizuan, si Mirjan Ribit, Aranit Rjepi, bizneset me një shërbim të përsosur, si përherë Zeqo Hoxha familjarisht, por kësaj radhe edhe Vangjel Ribit me ekipin e tij, të cilët ia shtuan bukurinë takimit të brezave. Jemi të ndërgjegjshëm se, nëse njoftimi do të kishte qenë shumë më herët,

pjesëmarrja do të ishte shumë më e madhe, sidomos nga emigrantët, problem që vitin tjetër duhet të mbahet në konsideratë që masat për organizimin dhe njoftimin e datës së takimit të brezave, duhet bërë jo më vonë se muaji mars të çdo viti. Ajo që ranë sy kësaj radhe ishte pjesëmarrja e fisit Zeqaj të Kallaratit me banim në Borsh, të cilët për herë të parë iu bashkuan bashkëfshatarëve të tyre, ashtu si edhe pjesëtarët e fisit Jonuzaj të Penkovës dhe plot të tjerë. Nga fshatrat fqinjë do të veçonim grupin e Vranishtit të ulur në një tavolinë të veçantë, të cilët me këngët labe të kënduara e gjallëruan së tepërmi veprimtarinë festive.



Është viti i dytë që këngëtarit, Gjergj Leskaj me orkestrën e tij, shpalosi para bashkëfshatarëve dhe moshatarëve të tij, talentin e tij, tashmë të afirmuar me albumin "Jam bir nga Labëria" dhe këngët e tjera të kënduara prej tij. Edhe pse një natë më parë ai kishte kënduar në të njëjtin takim brezash në Vranisht, ai i dha atmosferë gjithë takimit deri në orët e para të mëngjesit të datës 22 gusht.

Takimi si përherë filloi me ekzekutimin e Himnit Kombëtar të Republikës së Shqipërisë, pastaj fjalën e mori i zoti i shtëpisë, kryetari i fshatit, zoti Lefter Qejvani, i cili pasi falënderoi të ardhurit në këtë takim, evidentoi dhe kërkoi një minutë heshtje për gjithë bashkëfshatarët kallarasit të ndarë nga jeta qënga takimi vitit të kaluar si: Xhelo Dautaj, Bardhosh Breshani, Arjana Dautaj, Selvi Tozaj, Sarta Tartari (Hoxhaj), Drita Muharremi, Hyso Xhaferaj, Budin Demiri, Peshqeshe Qejvani, Agron Jonuzaj, Nako Shakaj, Enver Golloshi, Amali Tozaj, Hanushe Strataj, Seit Jonuzaj, Hava Hysaj e Sirma Kondi.

Më tej Lefteri falënderoi ata që bënë të mundur sponsorizimin e këtij takimi si Mirjan Ribin, Aranit Rjepin e të tjerë dhe në mbyllje uroi që të kalonim një mbrëmje të gëzuar të gjithë së bashku nën tingujt e orkestrës dhe këngëtarit Gjergj Leskaj si dhe këngës labe, shoqëruar me ushqimin dhe pijen tradicionale të Kallaratit.

NË "TAKIMIN E BREZAVE" NË KALLARAT, PËRKUJTOHET "BILBILI I LABËRISË", BIRI I TIJ, HYSO BALIL XHAFERAJ.



Nuk kishte si ndodhte ndryshe, të mblidheshim në Kallarat e të mos kujtonim një nga bilbilat e Labërisë, atë që me zërin e tij na kish bërë krenarë e na kish lartësuar emrin e fshatit tonë, Kallaratit, Hyso XHAFERAJ. Prandaj edhe organizatorët e takimit kishin menduar edhe për këtë detaj shumë të rëndësishëm e kuptimplotë. Pas fjalës së hapjes nga kryetari i fshatit, zoti Lefter Qejvani dhe disa këngëve e valleve popullore, pranë mikrofonit një tjetër organizator i takimit, z. Besnik Gjonbrataj e merr fjalën në të cilën ndërmjet të tjerash theksoi: "Kësaj mbrëmje të bukur e festive i mungojnë edhe shumë bashkëfshatarët të tjerë, cilët nuk kanë mundur vinin. Kësaj mbrëmje i mungojnë edhe ata të cilët janë ndarë nga jeta kohët e fundit. Por kësaj mbrëmje i mungon një nga bijtë e saj, i ndarë para kohe nga jeta, i mungon "Bilbili i Këngës

labe", ai që me zërin e tij të veçantë theu qelqet e qiellit, Hyso Balil Xhaferaj. Hysua i këndoi me dashuri popullit të tij, në të gjitha skenat kombëtare e ndërkombëtare në përbërje të Ansambli Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore. Ai këndoi përkrah Mjeshtrove të mëdhenj si: Hysni Zelës, Irini Qirjakos, Nazif Çelës së Lapardhasë, Mimoza Kosturit me grupin e Zagories, me grupin "Buronjat Labe" me udhëheqës artistik të paharruarin, poetin e Labërisë, Nertesë Asallanin, me grupin "Zadeja", me grupin "Antea", me grupin e Pilurit, me grupin e famshëm "Ëest Side Family", me artisten e madhe vlonjate, Aurela Gaçen. E me kë nuk këndoi e do të këndonte Hyso Xhaferaj, duke na bërë krenar që përfaqësonte me dinjitet vlerat më të spikatura të Kallaratit, të Lumit të Vlorës e të krejt Labërisë.

Hysua përveç planeve artistike me ansamblin, kishte si ide të tij ngritjen e grupit të Kallaratit, ku të bashkonte artistikisht zërin e tij me zërin e Zeqos, Gjenës, Gjergjit, Renatos, Simonit, Andonit, Myzaferit, Vangjelit etj. Por ja që zoti e mori para kohe dhe e dërgoi atje lart në qiell, për të na parë nga larg. Me siguri këtë ëndërr e dëshirë të tij do ta plotësojnë shokët e tij. Kush nuk qau e derdhi lot për Hyson, kush nuk thuri vargje e këngë e këndoi për të, që nga familjarët, kolegët e ansamblit, artistë, këngëtarë, poet, shkrimtar, personalitete të larta të muzikës e kulturës, miq e shok të tij të shumtë, në bashkëfshatarët e tij, por Hysua, siç shprehet poeti Nexhip Onjea "Do të rrojë sa të rrojë vetë kënga". Poeti i madh Lefter Çipa, "Nderi i Kombit" para ndarjes nga jeta do ta vilësonte Hyso Xhaferajn "Gurë xhevairi", ndërsa kompozitori dhe drejtori i Ansambli, Sokol Marsi pas vdekjes së Hysos do të shprehej "Luanët një Vdekje kanë", etj.

Hysua sa që gjallë që nderuar nga presidenti i Republikës me Urdhrin "Naim Frashëri", Shoqata, Labëria me titullin "Personaliteti i Shquar i Labërisë", atë e nderoi Lunxheria në festivalin zonal, atë e nderoi Piluri në festivalin "Netët e Bejkës së Bardhë", ku i këndoi edhe Zeqaja ynë me vajtimin e tij karakteristik me tekst të Kristo Çipës. Vlerësimet për të nuk kanë të mbaruar. Hysua do të mbetet për ne "Krenaria e Kallaratit", që ai e dëshoi aq shumë dhe e thoshte me krenari e dinjitet edhe kur ndodhej jashtë vendit "Jam nga Kallaratit".

Për Hyson kanë shkruar e do të shkruajnë edhe më vonë, por në këtë mbrëmje, për nder të veprës së tij të ndritur, për atë ai çfarë la si trashëgimëni, këngën labe, le të ndjekim baladën: "Ti do të rrosh, sa të rrojë vetë Kënga" me tekst të poetit nga Fushëbardha e Gjirokastrës, mikut të tij të ngushtë, Nexhip Onjea, interpretuar nga aktori Bujar Asqeriu, "Nderi i Kombit", si dhe këngën labe, po me tekst të Nexhip Onjesë, kënduar nga shoku dhe miku i tij i veçantë, Nazif Çela.



Menjëherë pas kësaj fjale të shkurtër, por shumë të vlerësuar, të pranishmit, midis tyre, pjesëtar të familjes Xhaferaj, vëllai, motrat, djali, xhaxhai e të afërm të tjerë, ardhur enkas për këtë eveniment, ndoqën me shumë emocione, lot, por edhe me krenari interpretimin brilant të Bujar Asqeriu "Nderi i Kombit", mbështetur në vargjet e zgjedhura e të skalitura siç di vetë, poeti Nexhip Onjea, e në vijim këngën e kënduar nga Nazif Çela, nga miku dhe shoku i tij i ngushtë, me të cilin u kishin kënduar shumë zemrave të

thyera e të lënduara nga humbja e njerëzve të tyre të shtrenjtë.



Duartrokjetet e të pranishmëve, përveçse një respekt e mirënjohje ndaj figurës së Hysos, tregojnë e flasin qartë se, Hysua do të jetë gjithmonë mes nesh, me zërin dhe këngën e Tij në çdo eveniment të vendlindjes, Kallaratit. "Ai do të rrojë, sa të rrojë vetë kënga". Në emër të familjes dhe të afërmeve të Hysos, përshëndeti, vëllai i tij, Bakua, i cili falënderoi gjithë bashkëfshatarët për ngushëllimet, mesazhet, komentet, këngët, shkrimet e krijimet e bëra e të shprehura për djalin, bashkëshortin, prindin, vëllain e tyre të paharruar Hyson dhe duke ju uruar atyre shëndet, gëzime e lumturi në familjet e tyre.

Në fund për të pranishmit u shpërnda falas gazeta Kallaratit, botim special në kujtim të jetës dhe aktivitetit artistik të "Bilbilat të Labërisë", Hyso XHAFERAJ.

MESAZH I VEÇANTË I POETIT NEXHIP ONJEA, PËR TAKIMIN E BREZAVE NË KALLARAT.



Poeti Nexhip Onjea, një nga miqtë e shokët e rrallë të "Bilbilat të Labërisë", djalit kallarasit, Hyso Xhaferaj, i cili është edhe autor i tekstit të baladës "Ti do të rrosh sa të rrojë kënga" interpretuar nga aktori Bujar Asqeriu "Nderi i Kombit", autor i tekstit të këngës, kënduar nga këngëtarit Nazif Çela, kushtuar Hysos pas ndarjes nga jeta, me rastin e "Takimit të Brezave" në Kallarat, në kujtim të tij na dërgon mesazhin e mëposhtëm:

"Të dashur miq! Megjithatë kisha vendosur që para një viti që do vijë të festoja bashkë me ju, vdekja e parakohshme e vëllait tim shpirtëror, Hyso

Më 21 gusht 2022 në Kallarat u zhvillua "Takimi i Brezave"

(Përmbledhje për gazetën, nga Besnik Gjonbrataj)

Xhaferaj, nuk ma mundësoi këtë gjë! U mbledhshi gjithmonë për festa e gëzime! Festoni dhe për shpirtin e Hysos që e donte aq shumë vendlindjen e tij. Shpirti i tij sot feston me ju! Festoni dhe për shpirtin e atyre që këtë vit janë ndarë fizikisht nga ju! Gëzuar miq! Nga mot më mirë! Përfaqime të gjithëve – përfundon mesazhin poeti Onjea.

Në emër të Kryesisë së fshatit, Kryesisë së Shoqatës Kallarat, në emër të gjithë bashkëfshatarëve, miqve e shokëve të Hysos tonë, falënderojmë pa masë poetin Nexhip Onjea, si një nga dashamirësit e Hysos dhe i urojmë atij suksese në krijimtarinë letrare dhe në veçanti në tekstet e këngëve polifonike. Ashtu siç theksoni Ju "Hysua do rrojë, sa të rrojë kënga"



FISI ZEQAJ NGA BORSHI ME ORIGINË TË HERSHME NGA KALLARATI MERR PJESË PËR HERË TË PARË NË TAKIMIN E BREZAVE.

Altin Zeqaj nga Borshi, me origjinë të hershme nga Kallarat, ishte ndër të parët që konfirmoi pjesëmarrjen pas njoftimit të hedhur në fb nga kryesia e Shoqatës. Ja si shkroi Altini te fejsbuku i shoqatës: "Përshëndetje shoqata Kallarat! Konfirmoj pjesëmarrjen në takimin e brezave në Kallarat. Për herë të parë do sjell babain në fshatin e të parëve të tij dhe fëmijët që të shikojnë e shijojnë AROMË LABËRIE. Mezi presim të dielën që të takojmë Brahim Goxhaj, i cili na mirëpret në vatrën e tij. Uroj dhe shpresoj që të ketë sa më shumë kallaratas dhe jo vetëm. Mirë u takofshim në Kallarat - përfundonte mesazhin e tij Altini. Këtë njoftim Altini e bëri realitet, ku në mbrëmje në një tavolinë të veçantë në pritjen e organizuar mjaft mirë nga Brahim Goxhaj, fisi Zeqaj ishte i pranishëm nga më të moshuarit deri te të vegjlit, një ndërthurje perfekte e brezave. Këtë pjesëmarrje të tyre në takimin e brezave në Kallarat e realizoi falë këmbënguljes së Altin Zeqaj. Altini është një djalë i lindur e rritur në Borshin e bukur buzë Jonit,

banues në Tiranë, që edhe pse stërgjyshi e gjyshi i tij kanë lindur në Borsh, me krenari e quan veten kallaratas, pasi sipas asaj që ai ka trashëguar nga i ati, por edhe gjyshi, rreth viteve 1800 të parët e fisit Zeqaj për arsye të ndryshme u shpërngulën nga Kallarat dhe u vendosën në Borsh. Aty ndërtuan jetën brez pas brezi me shumë mund e djersë, duke sakrifikuar për veten e tyre, për të mirën e Borshit e të Atdheut. Por ata edhe sot e kësaj dite e quajnë veten se janë nga Kallarat. Ata kanë kaluar vite e breza të tërë të fisit Zeqaj që jetën e kanë ndërtuar më së miri në Borsh, Sasaj, Sarandë, Tiranë e jashtë vendit. Por kudo ku ata jetojnë e quajnë veten dhe i quajnë të tjerët vetëm kallaratas.



FALENDERIME NGA KRYESIA E SHOQATËS "KALLARATI" PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E TAKIMIT TË BREZAVE.

Falënderojmë gjithë pjesëmarrësit në "Takimin e Brezave" në Kallarat më 21 gusht 2022. Falënderojmë gjithë ata individë që kontribuan në organizimin dhe zhvillimin e këtij takimi, që edhe pse në një kohë të shkurtër, ia arriti qëllimit përtej pritshmërisë. Falënderojmë në mënyrë të veçantë sponsorin e orkestrës, z. Mirjan Ribin dhe sponsorin e ndriçimit dhe zbulimit të ambjentëve z. Aranit Rjepaj. Falënderojmë bizneset private, z. Zeqo Hoxha familjarisht dhe Vangjel Ribin për mundësinë e krijuar për shërbimin e afuar. Falënderojmë pjesëtarët e orkestrës, organistin Donin dhe klarinetistin Tanin, këngëtarin Gjergj Leskaj, të cilët me muzikën dhe këngët e kënduara i dhanë atmosferë të paparë takimit. Falënderojmë gjithë banorët e Kallaratit për bujarinë e treguar në pritjen e të ardhurave. Falënderojmë gjithë të ardhurit nga fshatrat fqinjë, në mënyrë të veçantë grupin e Vranishtit, që me këngët labe të kënduara, ia shtoi më shumë vlerat takimit. Falënderojmë kallaratasit e larguar shumë herët si: Jonuzaj e Penkovës dhe në mënyrë të veçantë pjesëtarët e fisit Zeqaj të Borshit, që merrnin pjesë për herë të parë në vendlindjen e stërgjyshërve të tyre. Falënderojmë pushtetin lokal dhe kryetarin z. Lefter Qejvani për gatishmërinë dhe angazhimin e tyre në organizimin dhe zhvillimin e takimit të brezave.

Falënderojmë gjithë përfaqësuesit e brezave, të moshave të ndryshme, që morën pjesë në këtë festë. Falënderojmë ata emigrantë kallaratas, që edhe pse njoftimit me vonë, mundën të merrnin pjesë. Falënderojmë të gjithë moshat e reja, sidomos fëmijët, të cilët nuk e harrojnë origjinën e tyre. Falënderojmë të gjithë të moshuarit, që edhe pse me probleme shëndetësore, u bënë pjesë e takimit, ku do të veçonim pjesëmarrjen e z. Abaz Dautit, ardhur familjarisht nga Durrësi. Falënderojmë gjithë ata të rinj e të reja që me vallëzimin e tyre deri në orët e vona të natës i dhanë atmosferë të veçantë takimit.

Gëzime paçim përherë të dashur bashkëfshatarë! Mirë u takofshim vitin tjetër.



FALENDERIM NGA KRYETARI I FSHATIT, Z. LEFTER QEJVANI

Të nderuar bashkëfshatarët e mi të mirë! Mbrëmë së bashku përjetuam një natë me të vërtetë magjike. Tre breza kënduan e vallëzuan së bashku me orë të tëra. Takimi i tejkaloi pritshmëritë tona lidhur me pjesëmarrjen. Sheshi qendror i fshatit gumëzhu për orë të tëra. Me shumë emocion përçollim in memoriam për bilbilin e Labërisë, Hysu Xhaferaj në interpretimin e aktorit Bujar Asqeriu dhe këngën e Nazif Çelës për Hysos, përgatitur me mjeshtëri nga Besnik Gjonbrataj, i cili ka një meritë të veçantë, jo vetëm për mbarëvajtjen e takimit, por edhe për mbajtjen në funksion të plotë të faqes së shoqatës "Kallarat" ne internet. Gjithashtu falënderoj ata që bënë sponsorizimin e takimit, si Mirjan Ribaj, Aranit Rjepaj, klubet private sitë Zeqos, por edhe atë të ngritur enkas për takimin nga Vangjel Ribin. Falënderoj të gjithë pjesëmarrësit dhe familjet kallaratase me banim në fshat që si gjithmonë u tregun mikpritës. Mirë u takofshim vitin tjetër!



AGIM MATAJ (KALLARATI), REALIZON MEMORIALIN E GREQISË

SALENTINE NË LEÇE TË ITALISË

Nga Besnik GJONBRATAJ



Jo më kot e kemi cilësuar edhe në shkrime të tjera që, Agimi tashmë në çdo punim që bën me krenari identifikohet me emrin mjaftë kuptimplotë e të bukur, "AGIM KALLARATI". Punimet e tij prej guri në Leçe të Italisë, e kanë bërë të njohur si një mjeshtër i vërtetë i gdhendjes artistikisht të gurit,

punimet e të cilit kanë kaluar deri në Amerikë, Kanada e patjetër në Evropë.

Para pak ditësh Agimi realizoi një memorial, kushtuar 12 fshatrave me origjinë greke në zonën e Leçës Itali, ku në përvënje të tij mori pjesë edhe Presidentja e Greqisë, Shkëlqesia e Saj, **Katerina Sakellariopoulou**, e cila i shprehu Agimit falënderimet e saj për punimin e realizuar.

Siç tregon vetë Agimi, kur ajo e pyeti. Italian jeni? Jo – jam shqiptar, jam Agim Kallaratit - iu përgjigja me plot krenari. Edhe pse shprehu një farë habie, ajo vlerësoi shumë punimin e kryer.

Me të drejtë mund të pyesni. Përse presidentja e Greqisë në këtë përvënje memoriali në Itali?

Në Leçe, ku punon e jeton Agimi, ndodhen rreth 12 komuna (fshatra) me origjinë greke. Nisur nga emri i mirë, që Agimi ka bërë në realizimin e shumë punimeve artistike prej guri, i kërkuan kompozimin dhe bërjen e një monumenti me stemat e të gjithë fshatrave me rastin e 20 vjetorit. Agimi tregon se këto janë 12 fshatra për të cilat thuhet se janë me origjinë greke sepse kane folur greqisht, sidomos të vjetrit dhe me kalimin e kohës dhjetëra vjeçare, apo mund të themi dhe shekuj po fillonte të humbiste. Para 20 vjetësh u organizuan së bashku, bënë studime e gërmime dhe e rithemeluan të ashtuquajturën Greqia Salentine (Salentine sepse zona e Leçës quhet Salento, të themi si krahina e Kurveleshit apo Mesaplikut) dhe për 20 vjetorin kishin ftuar presidenten e



Greqisë, zonjën Katerina Sakellariopoulou, e cila ishte e pranishme në këtë event. U bë një simpozium ku folën për historinë, lidhjet me Greqinë etj. Folën për disa hapa që kanë bërë këto 20 vjet, ndër të cilat edhe për gjuhën greke që e kanë futur në shkollë dhe në fund u inaugurua dhe monumenti që unë bëra, i cili u pëlqye shumë, jo vetëm nga presidentja, por edhe nga të tjerët që kishin ardhur në këtë event. Nuk munguan komplimentet, qoftë nga ata që më njihnin më përpara, po ashtu edhe ata që kishin ardhur me këtë rast e më njohën aty, përfundon Agimi.

Po çfarë paraqet në vetvete monumenti?

Siç tregon Agimi, ai është krejtësisht punim artistik prej guri (pietra leccese) e ndërtuar sipas idesë së tij, me simbole të veçanta në greqisht për të treguar se në këtë zonë jeton një komunitet me origjinë të hershme greke. Në të katër faqet e kolonës janë gdhendur stemat e secilit fshat, ndërsa në bazament në dy anë të

kundërta është gdhendur, në një anë simboli i Greqisë dhe në tjetrën stema e Greqisë Salentine, ndërsa në dy faqet e tjera është shkruar në njërin italisht e në tjetrën greqisht eventin për të cilin u bë ceremonia.

Por në këtë monument, siç do t'i shikoni në foto, nuk mungon së shkruari edhe emri i autorit, Agim Mataj (KALLARATI), edhe pse në shumë punime të mëparshme për modesti Agimi nuk e shkruante emrin, por nga sugjerimet e kolegëve artistë, piktorë, skulptorë, është bindur që krahas modestisë, çdo vepër artistike, ka nevojë edhe për emrin, aq më tepër, kur vetë Agimi mbiemrin e ka për zell ta quaj "Agim Kallaratit".

Besoj duke shprehur edhe mendimin e gjithë kallaratasve, e falënderojmë Agimin për punimin e kryer, duke ngritur lart emrin e Tij, por edhe të vendlindjes, Kallaratit, duke e merituar plotësisht emrin "AGIM KALLARATI".

Suksese në punime të tjera!

